



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 65/2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 100/2017
“PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 3, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Deputeti Ralf Gjoni caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

2. Deputetja Aurora Mara caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Integrimin Europian.

3. Deputetet Amra Barova dhe Enada Kapllani (Koçiraj) caktohen anëtare zëvendësuese në Komisionin për Politikën e Jashtme.

4. Deputetet Edlira Hyseni dhe Enada Kapllani (Koçiraj) caktohen anëtare zëvendësuese në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

5. Deputetet Aurora Mara dhe Ediola Braha caktohen anëtare zëvendësuese në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

6. Deputeti Ylli Shehu caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 23.5.2019